

**Albania Marketing Service Shpk**  
**Pasqyrat financiare individuale**  
**për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018**  
**(me raportin e audituesve të pavarur bashkëngjitur)**

# Përmbajtja

	<u>Faqe</u>
Raporti i Audituesve të Pavarur	i-iii
Pasqyra individuale e pozicionit financiar	1
Pasqyra individuale e fitimit ose humbjes dhe të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse	2
Pasqyra individuale e ndryshimeve në kapital	3
Pasqyra individuale e flukseve të parasë	4
Shënime shpjeguese për pasqyrat financiare individuale	5 – 21



KPMG Albania Shpk  
Blvd "Dëshmorët e Kombit"  
Kullat Binjake Kulla 1, Kati 13  
Tiranë, Shqipëri  
+355(4)2274 524  
al-office@kpmg.com  
kpmg.com/al

## Raporti i Audituesve të Pavarur

Për pronarin dhe drejtimin e  
Albania Marketing Service Shpk

### *Opinion*

Ne kemi audituar pasqyrat financiare të Albania Marketing Service Shpk ("Shoqëria"), siç paraqiten në faqet 1 deri 21, të cilat përfshijnë pasqyrën e pozicionit financiar më 31 dhjetor 2018, pasqyrën e fitimit ose humbjes dhe të të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse, pasqyrën e ndryshimeve në kapital dhe pasqyrën e flukseve të parasë për vitin e mbyllur në atë datë, si dhe shënimet për pasqyrat financiare, përfshirë një përmbledhje të politikave të rëndësishme kontabël dhe shënime të tjera shpjeguese.

Sipas opinionit tonë, pasqyrat financiare bashkëlidhur japin një pamje të vërtetë dhe të drejtë të pozicionit financiar të Shoqërisë më 31 dhjetor 2018, të performancës së saj financiare dhe flukseve të saj të parasë për vitin e mbyllur në atë datë, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF).

### *Baza për Opinionin*

Ne e kryem auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA-të). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë përshkruar në mënyrë më të detajuar në seksionin e raportit ku jepen *Përgjegjësitë e Audituesve për Auditimin e Pasqyrave Financiare*. Ne jemi të pavarur nga Shoqëria në përputhje me Kodin e Etikës për Profesionistët Kontabël të Bordit të Standardeve Ndërkombëtare të Etikës për Profesionistët Kontabël (Kodi i BSNEPK) dhe me Kodin e Etikës të Institutit të Ekspertëve Kontabël të Autorizuar në Shqipëri (Kodi i IEKA), si dhe me kërkesat etike të Ligjit Nr. 10091, datë 5 mars 2009, "Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të Audituesit Ligjor dhe të Kontabilistit të Miratuar", të ndryshuar, që janë të zbatueshme për auditimin e pasqyrave financiare në Shqipëri, dhe kemi përmbushur përgjegjësitë e tjera etike në përputhje me këto kërkesa dhe me Kodin e BSNEPK dhe Kodin e IEKA. Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të dhënë një bazë për opinionin tonë.

### *Përgjegjësitë e Drejtimit në lidhje me Pasqyrat Financiare*

Drejtimi është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare në përputhje me SNRF-të, dhe për ato kontrole të brendshme që drejtimi i gjykon të nevojshme për të bërë të mundur përgatitjen e pasqyrave financiare që nuk përmbajnë anomali materiale, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit.

Në përgatitjen e pasqyrave financiare, drejtimi është përgjegjës për të vlerësuar aftësinë e Shoqërisë për të vazhduar në vijimësi, duke dhënë informacion, nëse është e zbatueshme, për çështjet që kanë të bëjnë me vijimësinë dhe duke përdorur parimin kontabël të vijimësisë përveç se në rastin kur drejtimi synon ta likuidojë Shoqërinë ose të ndërpresë aktivitetet, ose nëse nuk ka alternativë tjetër reale përveç sa më sipër.

### *Përgjegjësitë e Audituesve për Auditimin e Pasqyrave Financiare*


Objektivat tona janë që të arrijmë një siguri të arsyeshme lidhur me faktin nëse pasqyrat financiare në tërësi nuk kanë anomali materiale, për shkak të mashtrimit apo gabimit, dhe të lëshojmë një raport auditimi që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është një siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci që një auditim i kryer sipas SNA-ve do të identifikojë gjithmonë një anomali materiale kur ajo ekziston. Anomalitë mund të vijnë si rezultat i gabimit ose i mashtrimit dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose të marra së bashku, pritet që në mënyrë të arsyeshme të influencojnë vendimet ekonomike të përdoruesve, të marra bazuar në këto pasqyra financiare.

Si pjesë e auditimit në përputhje me SNA-të, ne ushtrojmë gjykimin profesional dhe ruajmë skepticizmin profesional gjatë gjithë auditimit. Ne gjithashtu:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e anomalisë materiale, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit në përgjigje të këtyre rreziqeve, dhe marrim evidencë auditimi që është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të siguruar një bazë për opinionin tonë. Rreziku i mos zbulimit të një anomalie materiale si rezultat i mashtrimit është më i lartë se rreziku si rezultat i gabimit, sepse mashtrimi mund të përfshijë marrëveshje të fshehta, falsifikime, përjashtime të qëllimshme, informacione të deformuara, anashkalime të kontroleve të brendshme.
- Sigurojmë një njohje të kontrollit të brendshëm që ka të bëjë me auditimin me qëllim që të përcaktojmë procedurat e auditimit që janë të përshtatshme sipas rrethanave, por jo për qëllime të shprehjes së një opinionimi mbi efikasitetin e kontrollit të brendshëm të Shoqërisë.
- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave kontabël të përdorura dhe arsyeshmërinë e çmuarjeve kontabël dhe të shpjegimeve përkatëse të bëra nga drejtimi.

- Nxjerrim një konkluzion në lidhje me përshtatshmërinë e përdorimit të bazës kontabël të vijimësisë, dhe bazuar në evidencën e auditimit të marrë, nëse ka një pasiguri materiale në lidhje me ngjarjet ose kushtet, e cila mund të hedhë dyshime të mëdha për aftësinë e Shoqërisë për të vijuar veprimtarinë. Nëse ne arrijmë në përfundimin që ka një pasiguri ne duhet të tërheqim vëmendjen në raportin e audituesve në lidhje me shpjegimet e dhëna në pasqyrat financiare, ose nëse këto shpjegime janë të papërshtatshme, duhet të modifikojmë opinionin tonë. Konkluzionet tona bazohen në evidencën e auditimit të marrë deri në datën e raportit tonë. Megjithatë, ngjarje ose kushte të ardhshme mund të bëjnë që Shoqëria të ndërpresë veprimtarinë.
- Vlerësojmë paraqitjen e përgjithshme, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare, përfshirë informacionet shpjeguese të dhëna, dhe nëse pasqyrat financiare paraqesin transaksionet dhe ngjarjet në to në një mënyrë që arrin paraqitjen e drejtë.

Ne komunikojmë me Drejtimin, përveç të tjerave, lidhur me qëllimin dhe kohën e auditimit dhe gjetjet e rëndësishme të auditimit, përfshirë ndonjë mangësi të rëndësishme në kontrollin e brendshëm që ne mund të identifikojmë gjatë auditimit.



Fatos Beqja  
Auditues Ligjor

KPMG Albania Shpk  
Blvd "Dëshmorët e Kombit"  
Kullat Binjake, Kulla 1, Kati 13  
Tiranë, Shqipëri

Tiranë, 10 shtator 2019

# Albania Marketing Service Shpk

## Pasqyra individuale e pozicionit financiar

(Vlerat në Lek)

	Shënime	31 dhjetor 2018	31 dhjetor 2017
<b>Aktive</b>			
Aktive afatgjata materiale	8	332,614,641	356,247,536
Aktive afatgjata jomateriale	9	1,736,795	3,335,958
Investime në filiale	7	17,665,200	-
<b>Totali i aktiveve afatgjata</b>		<b>352,016,636</b>	<b>359,583,494</b>
Llogari të arkëtueshme	10	754,897,879	716,077,476
Hua dhënë palëve të lidhura	11	-	749,261,884
Aktive të tjera	12	219,221,920	207,359,970
Parapagime per tatim fitimin	24	16,339,773	-
Mjete monetare dhe ekuivalente me to	13	250,772,276	565,128,720
<b>Totali i aktiveve afatshkurtra</b>		<b>1,241,231,848</b>	<b>2,237,828,050</b>
<b>Totali i aktiveve</b>		<b>1,593,248,484</b>	<b>2,597,411,544</b>
<b>Detyrimet dhe kapitali</b>			
Kapitali i nënshkruar	14	12,300,000	12,300,000
Rezervat	15	242,289,469	242,289,469
Fitimet e mbartura		760,646,773	1,520,868,589
<b>Totali i kapitalit</b>		<b>1,015,236,242</b>	<b>1,775,458,058</b>
Detyrime ndaj palëve të lidhura	18	72,707,233	299,581,840
Llogari të pagueshme	16	84,073,069	139,854,399
Tatim fitimi i pagueshëm	24	-	3,968,714
Detyrime të tjera	17	421,231,940	378,548,533
<b>Totali i detyrimeve afatshkurtra</b>		<b>578,012,242</b>	<b>821,953,486</b>
<b>Totali i detyrimeve dhe kapitalit</b>		<b>1,593,248,484</b>	<b>2,597,411,544</b>

Pasqyra individuale e pozicionit financiar duhet lexuar së bashku me shënimet shpjeguese në faqet 5 deri 21 që janë pjesë përbërëse e pasqyrave financiare.

**Albania Marketing Service Shpk**  
**Pasqyra individuale e humbjes ose fitimit dhe të ardhurave të tjera**  
**gjithëpërfshirëse**

(Vlerat në Lek)

	Shënime	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2018	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2017
Të ardhura nga shërbimet	19	3,805,683,217	3,590,025,036
Të ardhura të tjera	20	25,651,159	22,349,428
Shpenzime personeli:			
Shpenzime personeli të shërbimit	21	(1,991,262,978)	(1,768,488,569)
Shpenzime personeli administrativ	21	(301,682,873)	(280,493,386)
Zhvlerësimi dhe amortizimi	8,9	(138,789,243)	(102,574,075)
Zhvlerësimi llogarive të arketureshme	10	(4,712,470)	(34,609,200)
Shpenzime të tjera operative	22	(689,341,327)	(747,769,677)
<b>Fitimi nga aktivitetet operative</b>		<b>705,545,485</b>	<b>678,439,557</b>
Të ardhura financiare	11	23,175,949	18,036,884
Shpenzime financiare		(133,059,597)	(31,071,111)
<b>Shpenzime financiare, neto</b>	23	<b>(109,883,648)</b>	<b>(13,034,227)</b>
<b>Fitimi para tatimit</b>		<b>595,661,837</b>	<b>665,405,330</b>
Tatimi mbi fitimin	24	(108,883,653)	(122,907,949)
<b>Fitimi neto i periudhës</b>		<b>486,778,184</b>	<b>542,497,381</b>
Të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse, neto nga tatimi		-	-
<b>Totali i të ardhurave</b> <b>gjithëpërfshirëse për periudhën</b>		<b>486,778,184</b>	<b>542,497,381</b>

Pasqyra individuale e fitimit ose humbjes dhe të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse duhet lexuar së bashku me shënimet shpjeguese në faqet 5 deri 21 që janë pjesë përbërëse e pasqyrave financiare.

# Albania Marketing Service Shpk

## Pasqyra individuale e ndryshimeve në kapital

(Vlerat në Lek)

	Kapital i nënshkruar	Fitime të mbartura	Rezerva	Totali
<b>Gjendja më 1 janar 2017</b>	<b>12,300,000</b>	<b>978,371,208</b>	<b>242,289,469</b>	<b>1,232,960,677</b>
<b>Totali i të ardhurave gjithëpërfshirëse për vitin</b>				
Fitimi neto i vitit	-	542,497,381	-	542,497,381
Të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse, neto nga tatimi	-	-	-	-
<b>Totali i të ardhurave gjithëpërfshirëse për vitin</b>	<b>-</b>	<b>542,497,381</b>	<b>-</b>	<b>542,497,381</b>
<b>Veprime me pronarin, regjistruar direkt në kapital</b>	<b>-</b>	<b>-</b>	<b>-</b>	<b>-</b>
<b>Gjendja më 31 dhjetor 2017</b>	<b>12,300,000</b>	<b>1,520,868,589</b>	<b>242,289,469</b>	<b>1,775,458,058</b>
<b>Totali i të ardhurave gjithëpërfshirëse për vitin</b>				
Fitimi neto i vitit	-	486,778,184	-	486,778,184
Të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse, neto nga tatimi	-	-	-	-
<b>Totali i të ardhurave gjithëpërfshirëse për vitin</b>	<b>-</b>	<b>486,778,184</b>	<b>-</b>	<b>486,778,184</b>
<b>Veprime me pronarin, regjistruar direkt në kapital</b>				
Dividend distribution	-	(1,247,000,000)	-	(1,247,000,000)
<b>Total transactions with owners</b>	<b>-</b>	<b>(1,247,000,000)</b>	<b>-</b>	<b>(1,247,000,000)</b>
<b>Gjendja më 31 dhjetor 2018</b>	<b>12,300,000</b>	<b>760,646,773</b>	<b>242,289,469</b>	<b>1,015,236,242</b>

Pasqyra individuale e ndryshimeve në kapital duhet lexuar së bashku me shënimet shpjeguese në faqet 5 deri 21 që janë pjesë përbërëse e pasqyrave financiare.

Këto pasqyra individuale financiare u aprovuan nga Bordi i Drejtorëve të Shoqërisë Albania Marketing Service Shpk më datë 10 shtator 2019 dhe u nënshkruan në emër të saj nga:


  
Diego Pisa \*
   
Drejtor ekzekutiv


  
Studio Pustina



# Albania Marketing Service Shpk

## Pasqyra individuale e flukseve të parasë

(Vlerat në Lek)

	Shënime	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2018	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2017
<b>Flukset e parasë nga veprimtaritë e shfrytëzimit</b>			
Fitimi përpara tatimit		595,661,837	665,405,330
<i>Rregullime për:</i>			
Zhvlerësimi	8	136,978,572	101,356,593
Amortizim	9	1,810,671	1,217,482
Zhvlerësimi i të arkëtueshmeve	10	4,712,470	34,609,200
Të ardhura nga interesi	11	(23,175,949)	(18,036,884)
		<u>715,987,601</u>	<u>784,551,721</u>
<i>Ndryshime në:</i>			
Kërkesa për arkëtim		(43,532,873)	358,009,461
Aktive të tjera		(11,861,950)	(85,124,196)
Detyrime ndaj palëve të lidhura		(226,874,607)	87,399,148
Të pagueshme ndaj furnitorëve		(55,781,330)	90,820,187
Detyrimet e tjera		42,683,407	34,541,231
Flukset e parasë të gjeneruara nga veprimtaritë e shfrytëzimit		420,620,248	1,270,197,552
Tatim fitimi i paguar	22	(129,192,140)	(153,679,192)
<b>Flukset neto të parasë nga veprimtaritë e shfrytëzimit</b>		<b><u>291,428,108</u></b>	<b><u>1,116,518,360</u></b>
<b>Flukset e parasë nga veprimtaritë investuese</b>			
Blerje e aktiveve afatgjata materiale dhe jo materiale	8,9	(113,557,185)	(166,464,411)
Blerje e filialit	7	(17,665,200)	-
Hua dhënë palëve të lidhura	11	-	(731,225,000)
Arketim nga hua dhene palëve të lidhura	11	731,225,000	-
Interes i arketuar	11	41,212,833	-
<b>Flukset neto të parasë përdorur në veprimtaritë investuese</b>		<b><u>641,215,448</u></b>	<b><u>(897,689,411)</u></b>
<b>Flukset e parasë nga veprimtaritë financuase</b>			
Dividend i paguar		(1,247,000,000)	-
<b>Flukset neto të parasë përdorur në veprimtaritë financuase</b>		<b><u>(1,247,000,000)</u></b>	<b><u>-</u></b>
Rritja/(ulja) neto në mjetet monetare dhe ekuivalente me to		(314,356,444)	218,828,949
Mjete monetare dhe ekuivalente me to më 1 janar		565,128,720	346,299,771
<b>Mjete monetare dhe ekuivalente me to më 31 dhjetor</b>	13	<b><u>250,772,276</u></b>	<b><u>565,128,720</u></b>

Pasqyra individuale e flukseve të parasë duhet lexuar së bashku me shënimet shpjeguese në faqet 5 deri 21 që janë pjesë përbërëse e pasqyrave financiare.

# Albania Marketing Service Shpk

## Shënime shpjeguese për pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018

(Vlerat në Lek, përveçse kur thuhet ndryshe)

### 1. Informacion i përgjithshëm

Albania Marketing Service Shpk ("Shoqëria") u themelua si një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar më 20 shkurt 2009 dhe është e regjistruar në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit më 25 shkurt 2009. Shoqëria zotërohej plotësisht nga Albania Investment Holdings Mauritius deri më 14 shkurt 2018. Me pas aksionet e saj i janë shitur Teleperformance SE. Shoqëria mëmë përfundimtare është Teleperformance SE.

Aktiviteti kryesor i Shoqërisë është sigurimi i shërbimeve të telemarketingut klientëve të filialeve Italianë të Grupit Teleperformance.

Shoqëria vepron nëpërmjet dy qendrave të telefonisë në Tiranë dhe në Durrës. Më 31 dhjetor 2018 Shoqëria kishte 2,473 punonjës (2017: 2,093 punonjës).

Ne 2018 Shoqëria bleu 100% te kuotave te Service 800 Albania Shpk, e cila operon ne tregun e shërbimeve te telemarketingut dhe eshte pjese e grupit Teleperformance.

**Service 800 Albania Shpk** - është themeluar si një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar më 14 korrik 2009, dhe është e regjistruar në Qendrën Kombëtare të Biznesit më 20 korrik 2009.

### 2. Baza e përgatitjes

#### (a) Deklarata e përputhshmërisë

Pasqyrat financiare individuale janë paraqitur në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF).

Ky është seti i parë i pasqyrave financiare të Shoqërisë në të cilat aplikohen SNRF 15 *Të ardhurat nga kontratat me klientët* dhe SNRF 9 *Intrumentat Financiare*. Ndryshimet në politikat e rëndësishme kontabël janë paraqitur në shënimin 4.

#### (b) Baza e matjes

Pasqyrat financiare individuale janë përgatitur mbi bazën e kostos historike.

#### (c) Monedha funksionale dhe raportuese

Këto pasqyra financiare individuale janë paraqitur në Lek Shqiptar ("Lek"), e cila është edhe monedha funksionale e Shoqërisë.

### 3. Përdorimi i vlerësimeve dhe gjykime

Përgatitja e pasqyrave financiare individuale në përputhje me SNRF kërkon që drejtimi të bëjë gjykime, vlerësime dhe supozime të cilat ndikojnë në zbatimin e politikave kontabël dhe në shumat e raportuara të aktiveve, detyrimeve, të ardhurave dhe shpenzimeve. Rezultatet reale mund të ndryshojnë nga këto supozime.

Vlerësimet dhe supozimet rishikohen në mënyrë të vazhdueshme. Rishikimet e vlerësimeve kontabël njihen në periudhën në të cilën vlerësimi rishikohet dhe në periudhat e ardhshme që ndikohen.

#### i) Provisinet dhe ekspozimet fiskale

Për të përcaktuar nëse një provizion duhet të regjistrohet, Shoqëria bën gjykime nëse ka ndonjë të dhënë të dukshme që tregon se ka ndonjë rrezik të identifikuar dhe të matshëm në flukset monetare të ardhshme, për shembull ato që lidhen me tatimet dhe gjokat. Kjo evidencë mund të përfshijë të dhëna që tregojnë se ka pasur një ndryshim në kushtet ekonomike kombëtare dhe rajonale që lidhen me humbje të mundshme. Drejtimi përdor vlerësimet bazuar në humbje të shkuara dhe prova objektive të zhvillimeve aktuale të ngjashme kur bën vlerësimin e flukseve të ardhshme të parasë. Metodologjia dhe supozimet e përdorura për të vlerësuar si sasinë edhe kohën e flukseve monetare të ardhshme rishikohen rregullisht për të reduktuar diferencat midis vlerësimeve të humbjeve dhe përvojës me humbjet.

#### ii) Vlerat e drejta

##### *Aktivet financiare*

Meqë mjetet monetare në arkë, llogaritë në banka, llogaritë e arkëtueshme tregtare dhe të tjera janë afatshkurtra, vlera e drejtë e tregut për to konsiderohet të jetë e barabartë me vlerën e mbartur. Politikat për zhvlerësimin dhe çregjistrimin janë përshkruar në shënimin 5(g).

##### *Detyrimet financiare jo-derivative*

Detyrimet financiare janë afatshkurtra dhe vlera e drejtë e tyre është njohur e barabartë me vlerën e mbartur.

#### iii) Matja e HPK-ve për llogaritë e arketueshme

Politika e zhvlerësimit është përshkruar në shënimin 5(g).

# Albania Marketing Service Shpk

## Shënime shpjeguese për pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018

(Vlerat në Lek, përveçse kur thuhet ndryshe)

### 4. Ndryshime në politikat e rëndësishme kontabël

Shoqëria ka zbatuar fillimisht SNRF 15 (shih A) dhe SNRF 9 (shih B) nga 1 janari 2018. Nje numër standardesh të tjera janë efektive nga 1 janar 2018, por nuk kanë një efekt material në pasqyrat financiare të Shoqërisë. Për shkak të metodave të tranzicionit të zgjedhura nga Shoqëria për të zbatuar këto standarde, ne këto pasqyra financiare nuk është riparaqitur informacioni krahasues për të pasqyruar kërkesat e standardeve të reja përveç prezantimit ne menyre te vecante the zhvlerësimit per llogarite e arketueshme (shiko B).

#### A. SNRF 9 Instrumentat financiare

SNRF 9 parashtron kërkesa për njohjen dhe matjen e aktiveve financiare, detyrimeve financiare dhe disa kontratave për blerjen apo shitjen e zërave jofinanciare. Ky standard zëvendëson SNK 39 *Instrumentet Finaciare: Njohja dhe Matja*.

Gjithashtu, Shoqëria ka adoptuar ndryshimet pasuese sipas SNFR 1 Prezantimi i paqyrave financiare, e cila kërkon që zhvlerësimi i aktiveve financiare të paraqitet në një zë të veçantë në pasqyrën e fitimit ose humbjes dhe të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse. Më parë Shoqëria e përfshinte zhvlerësimin e të arkëtueshmeve tregtare në shpenzime të tjera operative. Rrjedhimisht, Shoqëria riklasifikoi humbjet nga zhvlerësimi në vlerë 34,609,200 LEK, të njohura sipas SNK 39, nga “shpenzimet e tjera operative” në “humbje nga zhvlerësimi i llogarive te arketueshme” në pasqyrën e fitimit ose humbjes dhe të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017.

#### (i) Klasifikimi dhe matja

SNRF 9 përmban tri kategori kryesore për klasifikimin e aktiveve financiare: të matura me koston e amortizuar, me vlerën e drejtë nëpërmjet të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse (VDATGj) dhe vlerën e drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes (VDPFH). Klasifikimi i aktiveve financiare sipas SNRF 9 përgjithësisht bazohet në modelin e biznesit sipas të cilit drejtohet një aktiv financiar dhe karakteristikat e tij kontraktuale të rrjedhës së flukseve monetare. SNRF 9 eliminon kategoritë e mëparshme të SNK 39: të mbajtura deri në maturim, huatë dhe të arkëtueshmet, të vlefshme për shitje. SNRF 9 kryesisht ruan kërkesat ekzistuese të SNK 39 për klasifikimin dhe matjen e detyrimeve financiare. Zbatimi i SNRF 9 nuk ka pasur efekt të rëndësishëm në politikat kontabël të Shoqërisë lidhur me detyrimet financiare. Për më tepër shpjegime mbi mënyrën se si Shoqëria mat dhe klasifikon instrumentet financiare dhe trajton fitimet dhe humbjet e lidhura me to sipas SNRF 9, shih Shënimin 5(b). Tabela e mëposhtme dhe shënimet shpjeguese përkatëse tregojnë kategoritë ekzistuese të matjes sipas SNK 39 dhe kategoritë e reja të matjes sipas SNRF 9 për çdo klasë të aktiveve dhe detyrimeve financiare më 1 janar 2018. Efekti i zbatimit të SNRF 9 në vlerën kontabël të aktiveve financiare më 1 janar 2018 lidhet vetëm me kërkesat e reja për zhvlerësim.

<i>Shumat në Lek</i>	<b>Shënimi</b>	<b>Klasifikimi fillestar sipas SNK 39</b>	<b>Klasifikimi i ri sipas SNRF 9</b>	<b>Vlera fillestare kontabël sipas SNK 39</b>	<b>Vlera e re kontabël sipas SNRF 9</b>
<b>Aktive Financiare</b>					
Llogari të arketueshme	10	Hua dhe të arkëtueshme	Kosto e amortizuar	716,077,476	716,077,476
Hua dhënë palëve të lidhura	11	Hua dhe të arkëtueshme	Kosto e amortizuar	749,261,884	749,261,884
Mjete monetare dhe ekuivalente me to	13	Hua dhe të arkëtueshme	Kosto e amortizuar	565,128,720	565,128,720
<b>Totali i aktiveve financiare</b>				<b>2,030,468,080</b>	<b>2,030,468,080</b>

#### (ii) Zhvlerësimi i aktiveve financiare

SNRF 9 zëvendëson modelin e “humbjes së ndodhur” sipas SNK 39 me modelin e “humbjes së pritshme të kredisë” (HPK). Modeli i ri i zhvlerësimit zbatohet për aktivet financiare të matura me kosto të amortizuar, aktivet kontraktuale dhe investimet në titujt e borxhit me VDATGj, por jo për investimet në instrumentet e kapitalit.

Efekti i zbatimit të SNRF 9 më 1 janar 2018 lidhet vetëm me kërkesat e reja për zhvlerësimin. Shoqëria ka percaktuar, qe nga aplikimi fillestar i SNFR 9 me 1 janar 2018 nuk ka nevojë te njihet zhvleresim shtese.

# Albania Marketing Service Shpk

## Shënime shpjeguese për pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018

(Vlerat në Lek, përveçse kur thuhet ndryshe)

### B. SNRF 15 Të ardhurat nga kontratat me klientët

SNRF 15 krijon një kuadër gjithëpërfshirës për të përcaktuar nëse, sa dhe kur do të njihen të ardhurat. Standardi i ri zëvendëson SNK 18 Të ardhurat. Sipas SNRF 15, te ardhurat njihen kur klienti merr kontrollin e produkteve ose shërbimeve. Përcaktimi i kohës së transferimit të kontrollit - në një moment kohor ose përgjatë kohës- kërkon gjykim. Shoqëria ka adoptuar SNRF 15 duke përdorur metodën e efektit kumulativ për periudhën që fillon më 1 janar 2018 dhe ka ndryshuar politikën e saj kontabël për njohjen e të ardhurave siç është detajuar në shënimin 5(i). Adoptimi i SNRF 15 nuk ndikoi në kohën ose shumën e të ardhurave nga kontratat me klientët.

### 5. Polotika të rëndësishme kontabël

Shoqëria ka zbatuar në mënyrë konsistente politikat kontabël të mëposhtme në të gjitha periudhat e prezantuara në këto pasqyra financiare, përveçse nëse përmendet ndryshe (shih shënimin 4).

#### (a) Transaksionet në monedhë të huaj

Transaksionet në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit në datën e transaksionit. Aktivitet dhe detyrimet monetare në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit në datën e raportimit. Fitimi apo humbja nga kursi i këmbimit për zërat monetarë është diferenca ndërmjet kostove të amortizuara në monedhën funksionale në fillim të periudhës, e rregulluar me interesin efektiv dhe pagesat gjatë periudhës, dhe kostove të amortizuara në monedhë të huaj të konvertuara me kursin e këmbimit në fund të periudhës.

Aktivitet dhe detyrimet jo-monetare në monedhë të huaj që maten me kosto historike konvertohen duke përdorur kursin e këmbimit në datën e transaksionit. Aktivitet dhe detyrimet jo-monetare në monedhë të huaj që maten me vlerë të drejtë konvertohen në monedhë funksionale me kursin e këmbimit në datën e përcaktimit të vlerës së drejtë. Diferencat nga kursi i këmbimit që rrjedhin nga shlyerja e transaksioneve në monedhë të huaj njihen në fitim ose humbje.

#### (b) Instrumentet financiare

##### (i) Aktivitet financiare jo- derivative

*Politika e zbatueshme nga 1 janari 2018*

Në njohjen fillestare, një aktiv financiar klasifikohet si i matur me: koston e amortizuar; VDATGj - investim në instrumente borxhi; VDATGj - investim në instrumente të kapitalit; ose VDPFH. Aktivitet financiare nuk riklasifikohen pas njohjes së tyre fillestare, përjashtuar rastin kur Shoqëria ndryshon modelin e saj të biznesit për drejtimin e aktiveve financiare, rast kur riklasifikohen të gjitha aktivitet e ndikuara.

Në njohjen fillestare të një investimi në kapital që nuk mbahet për shitje, Shoqëria mund të zgjedhë në mënyrë të pakthyeshme për të paraqitur ndryshimet e mëvonshme në vlerën e drejtë të investimit në të ardhurat e tjera gjithëpërfshirëse (ATGj). Një vendim i tillë merret individualisht për çdo investim.

Shoqëria bën një vlerësim të objektivit të modelit të biznesit në të cilin një aktiv mbahet në nivel portofoli pasi kjo reflekton më së miri mënyrën se si drejtohet biznesi dhe informacionin që i ofrohet drejtimit. Informacioni përfshin:

Aktivitet financiare - Vlerësimi i modelit të biznesit: Politika e zbatueshme nga 1 janari 2018

- politikat dhe objektivat e deklaruara për portofolin dhe funksionimi i këtyre politikave në praktikë. Këtu përfshihet nëse strategjia e drejtimit përqendrohet në fitimin e flukseve monetare kontraktuale, duke përputhur kohëzgjatjen e aktiveve financiare me kohëzgjatjen e ndonjë detyrimi të lidhur ose daljen e flukseve monetare ose duke realizuar flukset e mjeteve monetare nëpërmjet shitjes së aktiveve;
- si vlerësohet performanca e portofolit dhe si i raportohet drejtimit të Shoqërisë
- rreziqet që ndikojnë performancën e modelit të biznesit (dhe aktivitet financiare të mbajtura në këtë model biznesi) dhe si menaxhohen rreziqet.

*Politika e zbatueshme para 1 janarit 2018*

Instrumentet financiarë jo-derivative të Shoqërisë, përfshijnë shumat e kërkesave tregtare dhe të tjera, mjetet monetare dhe ekuivalente me to, llogari të pagueshme tregtare e të tjera, përfshirë të pagueshme ndaj palëve të lidhura. Instrumentet financiarë jo-derivative janë matur fillimisht me vlerën e drejtë plus, për instrumenta jo me vlerë të drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes, kostot e transaksionit që janë të lidhura drejtpërdrejt me to, përveç rasteve të përshkruara më poshtë.

Pas njohjes fillestare, njohja e instrumenteve financiarë jo-derivative përshkruhet më poshtë.

## **Albania Marketing Service Shpk**

### **Shënime shpjeguese për pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018**

*(Vlerat në Lek, përveçse kur thuhet ndryshe)*

#### **5. Polotika të rëndësishme kontabël (vazhdim)**

##### **(b) Instrumentet financiarë (vazhdim)**

*Mjete monetare dhe ekuivalente me to*

Mjetet monetare dhe ekuivalente me to përfshijnë vlerat në arkë dhe llogaritë rrjedhëse në bankë.

*Llogaritë e arkëtueshmet*

Llogaritë e arkëtueshme janë aktive financiare me pagesa fikse ose të përcaktuara që nuk janë regjistruar në një treg aktiv. Aktive të tilla njihen fillimisht me vlerën e drejtë të tregut, plus çdo kosto transaksioni që lidhet drejtpërdrejt me to. Pas njohjes fillestare llogaritë e arkëtueshme maten me metodën e koston së amortizuar duke përdorur metodën e interesit efektiv, minus çdo rënie të vlerës.

*(ii) Detyrime financiare jo-derivative*

*Të pagueshme tregtare dhe të tjera*

Llogaritë e pagueshme paraqiten me vlerën e tyre të drejtë dhe në vijim me kosto të amortizuar.

##### **(c) Filialet dhe konsolidimi**

Filialet janë njësi të kontrolluara nga Shoqëria. Kontrolli ekziston kur Shoqëria ka fuqinë, drejtpërdrejt ose tërthorazi, që të qeverisë politikat financiare dhe operative të një njësie ekonomike në mënyrë që të marrë përfitime nga aktivitetet e saj. Në vlerësimin e kontrollit merren parasysh të drejtat potenciale të votimit që aktualisht janë të ushtrueshme ose të konvertueshme.

Në përputhje me paragrafin 4 (a) të SNRF 10 Pasqyrat Financiare të Konsoliduara, Shoqëria plotëson kriteret për përjashtimin nga përgatitja e pasqyrave financiare të konsoliduara.

Mëma përfundimtare e Shoqërisë, Teleperformance SE, inkorporuar në Paris, France përgatit pasqyra financiare të konsoliduara që janë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar ("SNRF") dhe janë në dispozicion për përdorim publik. Pronarët nuk kundërshtojnë që Shoqëria të mos paraqesë pasqyra financiare të konsoliduara.

Investimet në filiale në këto pasqyra financiare individuale kontabilizohen me kosto. Më shumë detaje të investimit në filiale janë të vendosura në Shënimin 7.

Investimet testohen për zhvlerësim sa herë që ka tregues se vlera kontabël e mbetur e tyre mund të mos jetë e rikuperueshme. Nëse vlera e rikuperueshme e një investimi (vlera më e lartë midis vlerës së drejtë minus koston e shitjes dhe vlerës së tij në përdorim) është më e vogël se vlera kontabël e saj, vlera kontabël neto reduktohet në shumën e rikuperueshme. Vlera kontabël e mbetur e një investimi çregjistrohet gjatë nxjerrjes jashtë përdorimit. Diferenca midis vlerës së drejtë të fitimit nga shitjet dhe pjesës së mbetur të vlerës kontabël neto të investimit njihet në fitim ose humbje si fitim ose humbje nga shitja. E njëjta gjë vlen edhe nëse nxjerrja jashtë përdorimit rezulton në kalimin nga filiali në sipërmarrjen e përbashkët ose në pjesëmarrje të matur me kosto.

##### **(d) Kapitali i nënshkruar**

Kapitali i nënshkruar dhe i paguar i Shoqërisë njihet me vlerën nominale. Kostot rritëse direkt të ngarkuara në emetimin e aksioneve të reja paraqiten në kapital si deduksion, neto nga tatimi, nga të ardhurat. Çdo tejkalim i vlerës së drejtë të shumës së marrë mbi vlerën nominale të aksioneve të emetuara është regjistruar si premium i aksioneve në kapital. Dividendët regjistrohen si detyrim dhe zbriten nga kapitali në periudhën në të cilën ato janë deklaruar dhe miratuar. Për çdo dividend të deklaruar pas datës së bilancit dhe para se pasqyrat financiare individuale të autorizohen për publikim janë dhënë informacion shpjegues në shënimin e ngjarjeve pas datës së bilancit.

##### **(e) Aktivet afatgjata materiale**

*(iii) Njohja dhe matja*

Zërat e aktiveve afatgjata materiale paraqiten me kosto minus amortizimin e akumuluar dhe humbjet nga zhvlerësimi, nëse ka. Kostoja përfshin shpenzimet që janë drejtpërdrejt të ngarkueshme në blerjen e aktivitetit. Kostot e huamarrjes të lidhura drejtpërdrejt me blerjen, ndërtimin apo prodhimin e aktiveve të kualifikueshme njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve në momentin që ndodhin. Programet kompjuterike të blera që janë pjesë përbërëse e funksionimit të pajisjeve të lidhura me to kapitalizohen si pjesë e këtyre pajisjeve. Kur pjesë të një elementi të aktiveve afatgjata materiale kanë jetëgjatësi të dobishme të ndryshme, ato kontabilizohen si elemente të veçanta (komponentë kryesorë) të aktiveve afatgjata materiale.

# Albania Marketing Service Shpk

## Shënime shpjeguese për pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018

(Vlerat në Lek, përveçse kur thuhet ndryshe)

### 5. Përmbledhje e politikave kontabël (vazhdim)

#### (e) Aktivet afatgjata materiale (vazhdim)

##### (iii) Njohja dhe matja (vazhdim)

Humbjet dhe fitimet nga nxjerrja jashtë përdorimit e një aktivi afatgjatë material përcaktohen nga krahasimi i vlerës së arkëtuar nga nxjerrja jashtë përdorimit me vlerën e mbartur të aktivitetit dhe njihen neto tek të ardhurat e tjera në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

##### (iv) Kostot e mëpasshme

Kostot e zëvendësimit të një pjese të një elementi të aktiveve afatgjata materiale njihen në vlerën kontabël të aktivitetit afatgjatë material vetëm nëse është e mundur që Shoqëria të ketë përfitime të ardhshme ekonomike të lidhura me aktivin dhe kostoja e tij mund të matet në mënyrë të besueshme. Kostot e shërbimeve ditore të aktiveve afatgjata materiale njihen në fitime ose humbje në momentin që ato ndodhin.

##### (v) Amortizimi

Amortizimi llogaritet mbi shumën e amortizueshme, që është kostoja e një aktivi, ose shuma tjetër e zëvendësuar për koston, minus vlerën e tij të mbetur.

Amortizimi i aktiveve materiale llogaritet duke përdorur metodën lineare, me norma të cilat përafrojnë me jetën mesatare ekonomike të dobishme të aktiveve. Jetët e dobishme respektive për periudhën aktuale dhe krahasuese janë si në vijim:

Përmirësime të ambjenteve të marra me qira	2-5
Automjete	5
Mobilje dhe orendi	4-5
Pajisje telefonike	5
Pajisje kompjuterike	4-5

Metoda e amortizimit, jeta e dobishme dhe vlera e mbetur e aktiveve afatgjata materiale, nëse janë të konsiderueshme, riveleshohen në çdo datë raportimi.

#### (f) Aktivet afatgjata jomateriale

Aktivitetet e afatgjata jomateriale të blera nga Shoqëria paraqiten me kosto minus amortizimin e akumuluar dhe humbjet e akumuluar nga rënia në vlerë. Shpenzimet e mëpasshme për aktivitetet jomateriale kapitalizohen vetëm nëse është e mundur që Shoqëria të ketë përfitime të ardhshme ekonomike të lidhura me aktivin. Të gjitha shpenzimet e tjera njihen në momentin që ndodhin. Amortizimi njihet në fitim ose humbje duke përdorur metodën lineare. Periudha e amortizimit është 2-4 vjet.

#### (g) Zhvlerësimi

##### (i) Aktivet financiare

#### Politika e zbatueshme nga 1 janari 2018

Shoqëria njih zbritje për humbjet e pritshme të kredisë (HPK) për aktivitetet financiare të matura me koston e amortizuar. Zbritja e humbjeve për zhvlerësimin e të arkëtueshmeve tregtare maten gjithmonë me vlerën e barabartë me humbjet e pritshme të kredisë përgjatë gjithë jetës së aktivitetit. Gjatë vlerësimit nëse rreziku i kredisë i një aktivi financiar është rritur ndjeshëm që nga njohja fillestare dhe gjatë vlerësimit të humbjes së pritshme të kredisë, Shoqëria konsideron informacione të arsyeshme të cilat janë të disponueshme pa kosto apo përpjekje të tepërta. Kjo përfshin informacionin cilësor dhe sasior, bazuar në përvojën historike të Shoqërisë, vlerësimin e kredisë dhe informacionin për të ardhmen.

#### Matja e HPK-ve

HPK-të janë vlerësim i ponderuar me probabilitetin e humbjeve të kredisë. Humbjet e kredisë janë vlera aktuale e diferencave në flukset monetare (d.m.th diferenca mes flukseve monetare kontraktuale dhe mjeteve monetare që Shoqëria pret të arkëtojë).

Drejtimi ka përdorur lehtësinë praktike të zbatimit të matricave të provizioneve për të matur humbjet e pritshme të kredisë përgjatë gjithë jetës të llogarive të arkëtueshme që vlerësohen në baza kolektive.

Për llogaritë e arkëtueshme që vlerësohen individualisht, drejtimi vlerëson shumën e rikuperueshme duke përdorur metoda të ndryshme, në varësi të mënyrës se si pritet të rikuperohen shumat e arkëtueshme, si p.sh.:

- shuma e rikuperueshme sipas një skenari hipotetik likuiditeti;
- shuma e skontuar e shitjes sipas metodës fluks monetar/shërbimi i borxhit;

# Albania Marketing Service Shpk

## Shënime shpjeguese për pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018

(Vlerat në Lek, përveçse kur thuhet ndryshe)

### 5. Polotika të rëndësishme kontabël (vazhdim)

#### (g) Zhvlerësimi

##### (i) Aktivitetet financiare

- normat e rregulluara të provizionit (duke iu referuar normave të provizionit të përdorura për vlerësim kolektiv duke bërë përshtatje bazuar në skenarë specifikë si p.sh. kontratat me elementë të rëndësishëm të financimit).

#### **Paraqitja e zbritjes për HPK-të në pasqyrën e pozicionit financiar**

Zbritjet për HPK-të nga aktivitetet financiare të matura me kosto të amortizuara i zbriten vlerës kontabël bruto të aktiveve. Për letrat me vlerë të borxhit me VDATGj, humbja e kredisë kalon në fitimin ose humbjen e periudhës dhe njihet në ATGj.

Fshirja

Vlera kontabël bruto e një aktivi financiar fshihet kur Shoqëria nuk ka pritshmëri për rikuperimin e plotë ose të pjesshëm të tij. Shoqëria nuk pret rikuperim të konsiderueshëm nga shuma e fshirë. Megjithatë, aktivitetet financiare të çregjistruara mund të mbeten objekt i aktiviteteve përbarimore për të qenë në përputhje me procedurat e Shoqërisë për rikuperimin e shumave për t'u arkëtuar.

#### **Politika e zbatueshme para 1 janarit 2018**

Një aktiv financiar i cili nuk regjistrohet me vlerën e drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes vlerësohet në çdo datë raportimi për të përcaktuar nëse ka evidencë objektive që tregon se mund të jetë i zhvlerësuar. Një aktiv financiar konsiderohet i zhvlerësuar nëse ka evidencë objektive që se një ose më tepër ngjarje që kanë ndodhur kanë patur një ndikim negativ në flukset e vlerësuara të ardhshme të mjeteve monetare të tij.

Humbja nga zhvlerësimi e një aktivi financiar të matur me koston e amortizuar është llogaritur si diferencë ndërmjet vlerës kontabël dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme të vlerësuara të mjeteve monetare skontuar me normën fillestare të interesit efektiv të aktivitetit financiar. Aktivitetet financiare individualisht të rëndësishme testohen për zhvlerësim në bazë individuale. Pjesa e mbetur e aktiveve financiare, vlerësohet në grupe që ndajnë karakteristika të ngjashme rreziku.

Të gjitha humbjet nga zhvlerësimi njihen në fitim ose humbje. Një humbje nga zhvlerësimi mund të anulohet nëse ulja në zhvlerësim ka ndodhur për shkak të një ngjarjeje që ka ndodhur pasi është njohur zhvlerësimi. Për aktivitetet financiare që maten me kosto të amortizuara, anulimi njihet në fitim ose humbje.

##### (ii) Aktivitetet jo-financiare

Vlera kontabël e aktiveve jo-financiare të Shoqërisë, përveç aktiveve tatimore të shtyra rishikohet në çdo datë raportimi për të përcaktuar nëse ka ndonjë tregues zhvlerësimi. Nëse ka evidencë të tillë atëherë vlerësohet vlera e rikuperueshme e aktivitetit. Vlera e rikuperueshme e një aktivi ose njësie gjeneruese të mjeteve monetare është më e madhja midis vlerës së tij në përdorim dhe vlerës së tij të drejtë minus kostot e shitjes. Në vlerësimin e vlerës në përdorim, flukset e ardhshme monetare skontohen për të dhënë vlerën e tyre aktuale duke përdorur një normë skontimi përpara tatimit që pasqyron vlerësimet aktuale të tregut për vlerën në kohë të parasë dhe rreziqet specifike të aktivitetit. Për qëllime të testimi të zhvlerësimit, aktivitetet grupohen së bashku në njësinë më të vogël të aktiveve që gjenerojnë flukse hyrëse monetare nga përdorimi i vazhdueshëm, të cilat janë të pavarura nga flukset hyrëse monetare të aktiveve ose grupeve të tjera të aktiveve ("njësi gjeneruese të mjeteve monetare").

Humbja nga zhvlerësimi njihet nëse vlera kontabël e një aktivi ose e një njësie gjeneruese të mjeteve monetare e tejkalon shumën e rikuperueshme të vlerësuar. Humbjet nga zhvlerësimi njihen në fitim ose humbje. Humbjet nga zhvlerësimi të njohura në lidhje me një njësi gjeneruese të mjeteve monetare shpërndahen për të zvogëluar vlerën kontabël të aktiveve në njësi (grup njësisish) në varësi të peshës së secilit. Humbjet nga zhvlerësimi vlerësohen në çdo datë raportimit për çdo tregues që humbja është pakësuar ose nuk ekziston më. Humbja nga zhvlerësimi anulohet nëse ka patur një ndryshim në vlerësimin e përdorur për të përcaktuar shumën e rikuperueshme. Humbja nga zhvlerësimi anulohet vetëm në atë masë që vlera kontabël neto e aktivitetit nuk tejkalon vlerën kontabël neto të tij, që përcaktohet nga vlera neto e tij pas amortizimit, nëse nuk ka humbje nga zhvlerësimi.

#### (h) Përfitimet e punonjësve

##### (i) Skemë me kontribute të përcaktuara

Shoqëria paguan kontribute fikse për sigurimet shoqërore të detyrueshme për përfitimet e punonjësve të saj mbi daljen në pension. Detyrimet për kontribute në skemat e pensioneve me kontribute të përcaktuara njihen si shpenzim në fitim ose humbje kur ato ndodhin. Autoritetet lokale janë përgjegjëse për përcaktimin e limitit minimal ligjor të vendosur për pensionet, në bazë të një plani kontributësh të përcaktuara.

## **Albania Marketing Service Shpk**

### **Shënime shpjeguese për pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018**

*(Vlerat në Lek, përveçse kur thuhet ndryshe)*

#### **5. Polotika të rëndësishme kontabël (vazhdim)**

##### **(h) Përfitimet e punonjësve**

###### *(ii) Lejet vjetore të paguara*

Shoqëria njih si detyrim vlerën e paskontuar të kostove të vlerësuara në lidhje me lejet vjetore që pritet të paguhen në këmbim për shërbimin e punonjësve gjatë periudhës.

##### **(i) Provigjonet**

Provigjonet njihen kur Shoqëria ka një detyrim aktual (ligjor ose strukturor) si rezultat i një ngjarje të shkuar, dhe është e mundur që të kërkohej një dalje burimesh që përmbajnë përfitime ekonomike për të shlyer detyrimin, dhe që detyrimi të mund të matet në mënyrë të besueshme. Nëse efekti është material, provigjonet përcaktohen duke skontuar flukset e ardhshme të parasë me një normë para tatimit që reflekton vlerësimin aktual të tregut, të vlerës në kohë të parasë dhe, aty ku është e përshtatshme edhe rrezikun specifik të detyrimit. Provigjonet rishikohen në çdo datë raportimi dhe nëse nuk është më i mundshëm kushti për të cilin do të kërkohej materializimi i burimeve ekonomike për të shlyer detyrimin, atëherë provigjonet kthehen pas. Provigjonet përdoren vetëm për arsyen për të cilën janë njohur fillimisht. Provigjonet nuk njihen për humbje operative të ardhshme. Aktivet apo detyrimet e kushtezuara nuk njihen.

##### **(j) Njohja e të ardhurave**

Në maj të vitit 2014, IASB publikoi SNRF 15 "Të ardhurat nga kontratat me klientët", për të zëvendësuar SNK 18 "Të ardhurat", i cili përcakton parime për raportimin e informacionit të dobishëm për përdoruesit e pasqyrave financiare për natyrën, shumën, kohën dhe pasigurinë e të ardhurave dhe flukseve të parave që rrjedhin nga kontratat e një njësie ekonomike me klientët. Standardi është efektiv për periudhat vjetore që fillojnë nga 1 janari 2018, me aplikimin e kërkuar retrospektivë dhe lejon aplikimin më të hershëm. Adoptimi i SNRF 15 nuk ka një ndikim të rëndësishëm në pasqyrat financiare të Shoqërisë.

Të ardhurat maten me vlerën e drejtë të pagesës së marrë osë të arkëtueshme dhe përfaqësojnë shumën të arkëtueshme për shërbimet e kryera gjatë rrjedhës normale të biznesit, neto nga zbritjet dhe taksat e lidhura me shitjet.

Të ardhurat nga shërbimet e kryera njihen në fitim ose humbje në përpjestim me fazën e përmbushjes së transaksionit në datën e raportimit.

##### **(k) Pagesat e qirasë**

Pagesat e bëra për qiratë operative njihet në fitim ose humbje në mënyrë lineare përgjatë periudhës së qirasë. Stimujt e marrë për qiranë njihen si pjesë përbërëse e pagesës totale të qirasë përgjatë kohëzgjatjes së saj.

##### **(l) Të ardhurat dhe shpenzimet financiare**

Të ardhurat financiare përfshijnë të ardhurat nga veprimet në monedhë të huaj. Shpenzimet financiare përfshijnë shpenzimet nga veprimet në monedhë të huaj.

##### **(m) Tatimi mbi fitimin**

Tatimi mbi fitimin ose humbjen e vitit përfshin tatimin e periudhës aktuale dhe tatimin e shtyrë. Tatimi i periudhës aktuale dhe tatimi i shtyrë njihen në fitim ose humbje, përveçse kur lidhen me elementë që njihen drejtpërdrejt në kapital ose në të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse. Tatimi aktual është tatimi i pritshëm për t'u paguar mbi fitimin e tatueshëm të vitit, duke përdorur normat tatimore në fuqi ose thelbësisht në fuqi në datën e raportimit dhe çdo rregullim të tatimit për t'u paguar në lidhje me vitet e mëparshme.

Tatimi i shtyrë njihet në lidhje me diferencat e përkohshme ndërmjet vlerave kontabël neto të aktiveve dhe detyrimeve për qëllime të raportimit financiar dhe vlerave të përdorura për qëllime tatimi. Shuma e tatimit të shtyrë llogaritet duke përdorur normat tatimore që pritet të zbatohen mbi diferencat e përkohëshme kur këto të rikthehen, bazuar në ligjet në fuqi ose miratuar në datën e raportimit financiar. Në përcaktimin e shumës së tatimit aktual dhe të shtyrë, Shoqëria merr parasysh ndikimin e pozicioneve të pasigurta tatimore dhe nëse mund të jenë detyrime dhe interesa shtesë. Shoqëria beson se konstatimet e saj për detyrimet tatimore qëndrojnë për të gjitha vitet e hapura tatimore bazuar në vlerësimin e shumë faktorëve, duke përfshirë interpretimin e ligjit të taksave dhe përvojën e mëparshme. Ky vlerësim mbështetet në vlerësime dhe supozime dhe mund të përfshijnë një seri gjykimesh rreth ngjarjeve të ardhshme. Në kushtet e më shumë informacioni Shoqëria mund të ndryshojë gjykimet e saj në lidhje me përshtatshmërinë e detyrimeve tatimore ekzistuese; ndryshime të tilla në detyrimet tatimore do të ndikojnë në shpenzimet tatimore në periudhën kur merret një vendim i tillë.



# Albania Marketing Service Shpk

## Shënime shpjeguese për pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018

(Vlerat në Lek, përveçse kur thuhet ndryshe)

### 5. Polotika të rëndësishme kontabël (vazhdim)

#### (m) Tatimi mbi fitimin (vazhdim)

Një aktiv tatimor i shtyrë njihet për aq sa është e mundur që fitimi i tatueshëm i ardhshëm do të jetë i disponueshëm kundrejt të cilit të mund të përdoren diferencat e përkohshme. Aktivet tatimore të shtyra rishikohen në çdo datë raportimi dhe zvogëlohen për aq sa nuk është e mundur që përfitimi tatimor të realizohet.

Aktivitet dhe detyrimet tatimore të shtyra paraqiten neto nëse ka një të drejtë ligjore për të kompensuar aktivitet dhe detyrimet aktuale tatimore, dhe ato lidhen me tatime mbi të ardhurat të vendosura nga i njëjti autoritet tatimor, për të njëjtin subjekt tatimor, ose mbi subjekte të ndryshme tatimore, por ata kanë për qëllim të shlyejnë detyrimet dhe aktivitet aktuale tatimore në bazë neto, ose aktivitet dhe detyrimet tatimore do të realizohen në të njëjtën kohë.

#### (n) Standarde dhe politika të reja ende të pa adoptuara

Një numër standardesh të reja, ndryshime në standarde dhe interpretime janë efektive për periudhat vjetore që fillojnë pas 1 janarit 2018 dhe nuk janë aplikuar më herët në përgatitjen e këtyre pasqyrave financiare. Ato që mund të jenë relevante për Shoqërinë janë paraqitur më poshtë.

#### *SNRF 16 Qiratë*

SNRF 16 zëvendëson udhëzimet ekzistuese për qiratë, duke përfshirë SNK 17 *Qiratë*, KIRFN 4 *Përcaktimi nëse një Marrëveshje përmban një Qira*, KIS-15 *Qiratë Operative - Stimujt* dhe KIS-27 *Vlerësimi i Përmbajtjes së Transaksioneve që Përfshijnë Formën Ligjore të një Qiraje*. Standardi i ri sjell një model të vetëm kontabël të paraqitjes në bilanc të qirave nga qiramarrësit. Një qiramarrës njihet një aktiv për të drejtën e përdorimit që përfaqëson të drejtën e tij të përdorimit të aktivitet bazë dhe një detyrim qiraje që përfaqëson detyrimin e tij për të bërë pagesa qiraje. Ka përjashtime nga njohja për qiratë afatshkurtra dhe qiratë e aktiveve me vlerë të ulët. Kontabiliteti nga qiradhënësi mbetet i ngjashëm me standardin aktual – pra, qiradhënësi do të vazhdojnë të klasifikojnë qiratë si financiare ose operative. Standardi hyn në fuqi për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas datës 1 janar 2019 duke lejuar edhe zbatim më të hershëm për njësitë ekonomike që zbatojnë SNRF 15 në ose para datës së zbatimit fillestar të SNRF 16.

Shoqëria e ka përfunduar një vlerësim të ndikimit të mundshëm të SNRF 16 në pasqyrat e saj financiare. Bazuar në informacionin në dispozicion, Shoqëria vlerëson që do të njohë një detyrim për pagesa qiraje prej 10,566 mijë lekë më 1 janar 2019. Ndikimi në pasqyrat financiare, në momentin e aplikimit fillestar, do të varet nga kushtet e ardhshme ekonomike, duke përfshirë koston e huamarrjes së Shoqërisë më 1 janar 2019, përbërjen e portofolit të qirave të Shoqërisë në atë datë, vlerësimin nëse Shoqëria do të ushtrojë opsionin e rinovimit të kontratave të qirasë dhe shkalla me të cilën Shoqëria do të zgjedhë të përdorë përjashtime në njohje.

Deri më tani, ndikimi më i rëndësishëm i identifikuar është se Shoqëria do të njohë aktive dhe detyrime të reja për qiratë e saj operative të ambienteve.

Për më tepër, natyra e shpenzimeve që lidhen me ato qira do të ndryshojë tashmë pasi SNRF 16 zëvendëson shpenzimet e njëtrajtshme të qirasë me shpenzimin e amortizimit të së drejtës së përdorimit të aktiveve me qira dhe shpenzimin e interesit mbi detyrimet e qirasë.

#### *Standarde dhe interpretime të tjera*

- KIRFN 23 Pasiguritë mbi Trajtimet e Tatimit mbi Fitimin
- Veçoritë e Parapagimit me Kompensim Negativ (Ndryshimet në SNRF 9)
- Interesat Afatgjatë në Pjesëmarrje dhe Sipërmarje të Përbashkëta (Ndryshimet në SNK 28)
- Ndryshimet, Shkurtime ose Shlyerjet e Planit të Pensioneve (Ndryshimet në SNK 19)
- Përmirësimet vjetore të SNRF: 2015-2017 – standarde të ndryshme
- Përcaktimi i nje biznesi (Ndryshimet në SNRF 3)
- Përcaktimi i materialeve (Ndryshimet në SNK 1 dhe SNK 8)
- Shitja ose Kontributi i Aktiveve mes një Investitori dhe Pjesëmarrjes ose Sipërmarjes së Përbashkët përkatëse (Ndryshime në SNRF 10 dhe SNK 28)
- SNRF 17 Kontratat e sigrimit

# Albania Marketing Service Shpk

## Shënime shpjeguese për pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018

(Vlerat në Lek, përveçse kur thuhet ndryshe)

### 6. Instrumentet Financiare - Vlera e drejtë dhe menaxhimi i rrezikut

#### 6.1 Përcaktimi i vlerës së drejtë

Vlera e drejtë e mjeteve monetare dhe ekuivalenteve me to është përafërsisht e njëjtë me vlerën e mbartur të paraqitur, për shkak të maturimit të tyre të shkurtër. Vlera e drejtë e kërkesave të arkëtueshme dhe të pagueshme është e përafërt me vlerën e mbartur për shkak të maturitetit të tyre afatshkurtër.

#### 6.2 Menaxhimi i rrezikut financiar

Shoqëria është ekspozuar ndaj rreziqeve të mëposhtme nga përdorimi i instrumenteve financiare:

- rreziku i kredisë
- rreziku i likuiditetit
- rreziku i tregut

Ky shënim paraqet informacion rreth ekspozimit të Shoqërisë ndaj secilit prej rreziqeve të mësipërme, objektivat, politikat dhe proceset e Shoqërisë për matjen dhe menaxhimin e rrezikut, dhe menaxhimin e kapitalit. Shënime të mëtejshme sasiore janë të përfshira në këto pasqyra financiare. Drejtimi i Shoqërisë mbart përgjegjësinë e përgjithshme për vendosjen dhe mbikëqyrjen e politikave të Shoqërisë për menaxhimin e rrezikut. Politikat e menaxhimit të rrezikut të Shoqërisë kanë për qëllim të identifikojnë dhe analizojnë rreziqet me të cilat përballet Shoqëria, për të vendosur limitet dhe kontrollet e duhura, dhe për të monitoruar rreziqet dhe zbatimin e limiteve. Politikat dhe procedurat e menaxhimit të rrezikut rishikohen rregullisht për të reflektuar ndryshimet në kushtet e tregut dhe në aktivitetet e Shoqërisë. Shoqëria, përmes trajnimeve, standardeve dhe procedurave të menaxhimit, synon të zhvillojë një ambient kontrolli konstruktiv dhe të disiplinuar në të cilin të gjithë punonjësit i kuptojnë rolet dhe detyrimet e tyre.

Drejtuesit e Grupit në zyrat qendrore vrojtajnë sesi drejtimi monitoron përputhjen me politikat dhe procedurat e menaxhimit të rrezikut të Shoqërisë dhe të vetë grupit dhe rishikon përshtatshmërinë e strukturës së menaxhimit të rrezikut në lidhje me rreziqet me të cilat përballet Shoqëria. Instrumentet financiarë kryesorë të Shoqërisë konsistojnë në vlerat në arkë dhe në bankë, llogaritë e arkëtueshme dhe të pagueshme tregtare dhe të tjera.

#### (a) Rreziku i kredisë

Rreziku i kredisë është rreziku i humbjes financiare të Shoqërisë nëse një klient ose një palë e një instrumenti financiar nuk arrin të përmbushë detyrimet e tij kontraktuale. Si pasojë e volumit të kufizuar dhe të llojshmërisë së klientëve bazë të Shoqërisë, të cilët janë më së shumti palët e lidhura, përqëndrimi i rrezikut për sa i përket kërkesave për arkëtim është i limituar. Për shumat që duhen paguar nga palët e lidhura, ju lutemi shihni shënimet 9 dhe 10. Vlera kontabël e aktiveve financiare përfaqëson ekspozimin maksimal ndaj rrezikut të kredisë:

	<b>31 dhjetor 2018</b>	<b>31 dhjetor 2017</b>
Llogari të arkëtueshme tregtare dhe të tjera	754,897,879	716,077,476
Hua dhënë palëve të lidhura	-	749,261,884
Mjete monetare dhe ekuivalente me to	250,124,149	564,379,316
	<b>1,005,022,028</b>	<b>2,029,718,676</b>

Ekspozimi maksimal ndaj rrezikut të kredisë për kërkesat për arkëtim në datën e raportimit sipas pozicionit gjeografik është:

	<b>31 dhjetor 2018</b>	<b>31 dhjetor 2017</b>
Vendas	15,895,970	13,550,018
Jo vendas	739,001,909	702,527,458
	<b>754,897,879</b>	<b>716,077,476</b>

#### Humbjet nga zhvlerësimi

Provizioni për kërkesat e dyshimta për arkëtim është caktuar në shumën e konsideruar të nevojshme për të mbuluar rrezikun potencial në mbledhjen e balancave të llogarive të arkëtueshme.

Analiza sipas vjetërsisë e kërkesave për arkëtim në datën e raportimit është:

	<b>31 dhjetor 2018</b>	<b>31 dhjetor 2017</b>
Më pak se një vit	751,859,957	716,077,476
Më shumë se një vit	63,996,392	56,246,000
Gjendje në fund të vitit	<b>815,856,349</b>	<b>772,323,476</b>
Provizione zhvlerësimi	(60,958,470)	(56,246,000)
Gjendje neto në fund të vitit	<b>754,897,879</b>	<b>716,077,476</b>

## Albania Marketing Service Shpk

### Shënime shpjeguese për pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018

(Vlerat në Lek, përveçse kur thuhet ndryshe)

#### 6. Instrumentet Financiare - Vlera e drejtë dhe menaxhimi i rrezikut (vazhdim)

##### 6.2 Menaxhimi i rrezikut financiar (vazhdim)

###### (b) Rreziku i likuiditetit

Rreziku i likuiditetit është rreziku që Shoqëria do ndeshet në vështirësi në përmbushjen e angazhimeve të lidhura me detyrimet financiare të cilat shlyhen duke dhënë para të gatshme ose ndonjë aktiv tjetër financiar. Drejtimi është në gjendje të përfitojë me shpejtësi pagesa nga palët e lidhura për kërkesat e arkëtueshme në kushtet e rënies së likuiditetit.

Më poshtë paraqiten aktivet dhe detyrimet financiare sipas maturitetit kontraktual duke përfshirë pagesën e interesave më 31 dhjetor 2018 dhe 2017:

<i>31 dhjetor 2018</i>	<b>Vlera kontabël</b>	<b>6 ose më pak muaj</b>
<i>Aktivët financiarë</i>		
Llogari të arkëtueshme tregtare dhe të tjera	754,897,879	754,897,879
Hua dhënë palëve të lidhura	-	-
Mjete monetare dhe ekuivalente me to	250,772,276	250,772,276
	<b>1,005,670,155</b>	<b>1,005,670,155</b>
<i>Detyrimet financiare</i>		
Detyrime ndaj palëve të lidhura	(72,707,233)	(72,707,233)
Llogari të pagueshme	(84,073,069)	(84,073,069)
	<b>(156,780,302)</b>	<b>(156,780,302)</b>
<b>Ekspozimi Neto</b>	<b>848,889,853</b>	<b>848,889,853</b>
<i>31 dhjetor 2017</i>	<b>Vlera kontabël</b>	<b>6 ose më pak muaj</b>
<i>Aktivët financiarë</i>		
Llogari të arkëtueshme tregtare dhe të tjera	716,077,476	716,077,476
Hua dhënë palëve të lidhura	749,261,884	749,261,884
Mjete monetare dhe ekuivalente me to	565,128,720	565,128,720
	<b>2,030,468,080</b>	<b>2,030,468,080</b>
<i>Detyrimet financiare</i>		
Detyrime ndaj palëve të lidhura	299,581,840	299,581,840
Llogari të pagueshme	139,854,399	139,854,399
	<b>439,436,239</b>	<b>439,436,239</b>
<b>Ekspozimi Neto</b>	<b>1,591,031,841</b>	<b>1,591,031,841</b>

###### (c) Rreziku i tregut

###### Rreziku i monedhës

Shoqëria ka balanca të konsiderueshme në Euro me klientët e saj, me palët e lidhura dhe kundrejt furnitorëve të saj, që e ekspozojnë Shoqërinë ndaj rrezikut të monedhës. Drejtimi nuk ka hyrë në ndonjë marrëveshje derivative për t'u mbrojtur nga ky rrezik. Kurset e këmbimit të përdorura përgjatë vitit ishin si më poshtë:

Lek	<b>31 dhjetor 2018</b>		<b>31 dhjetor 2017</b>	
	<b>Kursi mesatar</b>	<b>Kursi në datën e raportimit</b>	<b>Kursi mesatar</b>	<b>Kursi në datën e raportimit</b>
EUR	127.58	123.42	134.15	132.95
USD	108.00	107.82	119.08	111.10

Ekspozimi i Shoqërisë ndaj rrezikut të monedhës së huaj më 31 dhjetor 2018 dhe 2017 është si më poshtë:

<i>31 dhjetor 2018</i>	<b>Vlera kontabël</b>	<b>EUR</b>	<b>Lek</b>	<b>USD</b>
	<i>(vlera të paraqitura në Lek)</i>			
Llogari të arkëtueshme tregtare dhe të tjera	754,897,879	738,976,602	15,895,970	25,307
Mjete monetare dhe ekuivalente me to	250,772,276	244,958,688	5,813,588	-
Detyrime ndaj palëve të lidhura	(72,707,233)	(72,707,233)	-	-
Llogari të pagueshme tregtare	(84,073,069)	(63,716,986)	(17,923,138)	(2,432,945)
<b>Ekspozimi Neto</b>	<b>848,889,853</b>	<b>847,511,071</b>	<b>3,786,420</b>	<b>(2,407,638)</b>

## Albania Marketing Service Shpk

### Shënime shpjeguese për pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018

(Vlerat në Lek, përveçse kur thuhet ndryshe)

#### 6. Instrumentet Financiare - Vlera e drejtë dhe menaxhimi i rrezikut (vazhdim)

##### 6.2 Menaxhimi i rrezikut financiar (vazhdim)

##### (c) Rreziku i tregut

31 dhjetor 2017	Vlera			
	kontabël	EUR	Lek	USD
	<i>(vlera të paraqitura në Lek)</i>			
Llogari të arkëtueshme tregtare dhe të tjera	716,077,476	707,758,541	7,485,685	833,250
Hua dhënë palëve të lidhura	749,261,884	749,261,884	-	-
Mjete monetare dhe ekuivalente me to	565,128,720	555,252,305	9,876,415	-
Detyrime ndaj palëve të lidhura	(299,581,840)	(299,581,840)	-	-
Llogari të pagueshme tregtare	(139,854,399)	(106,580,167)	(33,274,173)	(59)
<b>Ekspozimi Neto</b>	<b>1,591,031,841</b>	<b>1,606,110,723</b>	<b>(15,912,073)</b>	<b>833,191</b>

##### Analiza e ndjeshmërisë

Duke menaxhuar rrezikun e normave të interesit dhe të këmbimit valutor, Shoqëria synon të zvogëlojë ndikimin e luhatjeve afatshkurtra në fitimet e Shoqërisë. Në një periudhë afatgjatë, sidoqoftë, ndryshimet e përhershme në kurset e këmbimit dhe normat e interesit mund të kenë një ndikim në fitim. Një forcim ose dobësim i Lek-ut sikurse tregohet më poshtë, kundrejt Euro do të zvogëlonte ose rriste respektivisht, kapitalin dhe fitimin me shumat e treguara më poshtë. Kjo analizë bazohet në një ndryshim prej 10% në kursin e këmbimit që Shoqëria e gjykon si të mundshëm në fund të periudhës së raportimit.

Lek	31 dhjetor 2018		31 dhjetor 2017	
	Rritje	Ulje	Rritje	Ulje
Euro	84,751,107	(84,751,107)	160,611,072	(160,611,072)
USD	(240,764)	240,764	83,319	(83,319)

##### Rreziku i normës së interesit

Më 31 dhjetor 2017 huaja dhënë palëve të lidhura fiton interes me normë fikse dhe ndryshimet në normat e interesit të tregut nuk do të kishin ndikim në pozicionin financiar të Shoqërisë.

##### Administrimi i kapitalit

Politika e Shoqërisë është ruajtja e një baze të fortë kapitali në mënyrë që të ruajë besueshmërinë e investitorëve dhe kreditorëve dhe të mbështesë zhvillimin e mëtejshëm të biznesit. Grupi monitoron kthimet nga kapitali, të cilat Shoqëria i përcakton si të ardhura neto të shfrytëzimit pjesëtuar për totalin e kapitalit. Drejtimi dhe Grupi gjithashtu monitorojnë nivelin e dividendëve.

Shoqëria synon ruajtjen e një balance midis kthimeve më të larta të cilat bëhen të mundura nga nivele më të larta borxhi dhe avantazheve dhe sigurisë që të jep një kapitalizim i fuqishëm.

Shoqëria nuk është subjekt i kërkesave rregullatore të kapitalit.

#### 7. Investimi ne filial

	31 December 2018	31 December 2017
Investimi ne filial	17,665,200	-
	17,665,200	-

Investimi ne filial perfshin investimin e mbajtur me kosto tek Service 800 Albania Shpk. Shoqëria bleu ne 2018 100% te kuotave te Service 800 Albania Shpk nga Ypiresia 800 – Teleperformance SA, per shumen 17,665,200 lek. Bazuar ne performance e filialit per vitin 2018 dhe 2017, Drejtimi nuk ka identifikuar tregues per zhvleresim.

## Albania Marketing Service Shpk

### Shënime shpjeguese për pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018

(Vlerat në Lek, përveçse kur thuhet ndryshe)

#### 8. Aktivet afatgjata materiale

	Kompjuter dhe pajisje	Mobilje dhe orendi	Pajisje telefonike	Përmirësime të ambjenteve me qira	Automjete	Totali
<b>Kosto</b>						
Më 1 janar 2017	<b>362,811,390</b>	<b>173,834,179</b>	<b>58,077,210</b>	<b>72,408,525</b>	<b>12,437,428</b>	<b>679,568,732</b>
Shtesa	63,816,310	57,190,376	805,902	42,695,019	-	164,507,607
<b>Më 31 dhjetor 2017</b>	<b>426,627,700</b>	<b>231,024,555</b>	<b>58,883,112</b>	<b>115,103,544</b>	<b>12,437,428</b>	<b>844,076,339</b>
Shtesa	39,917,532	30,776,157	9,113,943	33,538,045	-	113,345,677
<b>Më 31 dhjetor 2018</b>	<b>466,545,232</b>	<b>261,800,712</b>	<b>67,997,055</b>	<b>148,641,589</b>	<b>12,437,428</b>	<b>957,422,016</b>
<b>Amortizimi i akumuluar</b>						
Më 1 janar 2017	(209,465,752)	(89,703,901)	(29,934,155)	(48,761,685)	(8,606,717)	(386,472,210)
Shpenzimi i vitit	(56,532,153)	(26,051,998)	(8,144,475)	(9,402,461)	(1,225,506)	(101,356,593)
<b>Më 31 dhjetor 2017</b>	<b>(265,997,905)</b>	<b>(115,755,899)</b>	<b>(38,078,630)</b>	<b>(58,164,146)</b>	<b>(9,832,223)</b>	<b>(487,828,803)</b>
Shpenzimi i vitit	(69,744,927)	(32,814,770)	(9,271,454)	(23,921,915)	(1,225,506)	(136,978,572)
<b>Më 31 dhjetor 2018</b>	<b>(335,742,832)</b>	<b>(148,570,669)</b>	<b>(47,350,084)</b>	<b>(82,086,061)</b>	<b>(11,057,729)</b>	<b>(624,807,375)</b>
<b>Vlera kontabël</b>						
Më 1 janar 2017	153,345,638	84,130,278	28,143,055	23,646,840	3,830,711	293,096,522
<b>Më 31 dhjetor 2017</b>	<b>160,629,795</b>	<b>115,268,656</b>	<b>20,804,482</b>	<b>56,939,398</b>	<b>2,605,205</b>	<b>356,247,536</b>
<b>Më 31 dhjetor 2018</b>	<b>130,802,400</b>	<b>113,230,043</b>	<b>20,646,971</b>	<b>66,555,528</b>	<b>1,379,699</b>	<b>332,614,641</b>

# Albania Marketing Service Shpk

## Shënime shpjeguese për pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018

(Vlerat në Lek, përveçse kur thuhet ndryshe)

### 9. Aktivet afatgjata jomateriale

	Licensa për programe
<b>Kosto</b>	
Më 1 janar 2017	19,210,589
Shtesa	1,956,804
<b>Më 31 dhjetor 2017</b>	<b>21,167,393</b>
Shtesa	211,508
<b>Më 31 dhjetor 2018</b>	<b>21,378,901</b>
<b>Amortizimi i akumuluar</b>	
Më 1 janar 2017	(16,613,953)
Shpenzimi i vitit	(1,217,482)
<b>Më 31 dhjetor 2017</b>	<b>(17,831,435)</b>
Shpenzimi i vitit	(1,810,671)
<b>Më 31 dhjetor 2018</b>	<b>(19,642,106)</b>
<b>Vlera kontabël</b>	
Më 1 janar 2017	2,596,636
<b>Më 31 dhjetor 2017</b>	<b>3,335,958</b>
<b>Më 31 dhjetor 2018</b>	<b>1,736,795</b>

### 10. Llogari të arkëtueshme tregtare dhe të tjera

	31 dhjetor 2018	31 dhjetor 2017
<b>Palë të lidhura</b>		
IN & OUT S.p.a.	112,375,146	226,927,223
Gn Research S.p.A	161,901	264,642
Service 800 Albania Sh.p.k	4,285,253	6,397,900
TP Emea	86,980,059	58,101,259
TP Support Services Bmbh	11,399,062	4,245,475
TLScontakt Albania	7,152,119	7,152,118
Teleperformance Group Inc	25,307	833,250
Teleperformance Netherland	938,881	-
Teleperformance Colombia SAS	762,040	-
<b>Total Pale te Lidhura</b>	<b>224,079,768</b>	<b>303,921,867</b>
Të arkëtueshme të tjera	591,776,581	468,401,609
<b>Llogari të arkëtueshme bruto</b>	<b>815,856,349</b>	<b>772,323,476</b>
Zhvlerësimi për llogari të dyshimta e të këqija	(60,958,470)	(56,246,000)
<b>Llogari të arkëtueshme neto</b>	<b>754,897,879</b>	<b>716,077,476</b>

Lëvizjet për zhvlerësimin paraqiten si më poshtë:

	2018	2017
Gjendja në fillim të vitit	(56,246,000)	(21,636,800)
Shpenzim zhvlerësimi për vitin	(4,712,470)	(34,609,200)
<b>Gjendja në fund të vitit</b>	<b>(60,958,470)</b>	<b>(56,246,000)</b>

### 11. Hua dhënë palëve të lidhura

	31 dhjetor 2018	31 dhjetor 2017
<b>Gjendja me 1 janar</b>	749,261,884	-
Hua dhënë palëve të lidhura	-	731,225,000
Arketim principlali	(731,225,000)	-
Te ardhura interesi	23,175,949	18,036,884
Interes i arketuar	(41,212,833)	-
<b>Gjendja 31 dhjetor</b>	<b>-</b>	<b>749,261,884</b>

Hua dhënë palëve të lidhura përfshin hua dhënë Teleperformance SE bazuar në marrëveshjen e datës 19 maj 2017. Huaja ka një normë vjetore interesi prej 4% dhe është paguar plotësisht gjatë 2018.

## Albania Marketing Service Shpk

### Shënime shpjeguese për pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018

(Vlerat në Lek, përveçse kur thuhet ndryshe)

#### 12. Aktive të tjera

	31 dhjetor 2018	31 dhjetor 2017
Tatimi mbi vlerën e shtuar	194,463,570	153,493,873
Garanci për qira	12,272,458	45,253,582
Të tjera	12,485,892	8,612,515
	<b>219,221,920</b>	<b>207,359,970</b>

#### 13. Mjete monetare dhe ekuivalente me to

	31 dhjetor 2018	31 dhjetor 2017
Vlera në arkë	648,127	749,404
Vlera në llogari rrjedhëse	250,124,149	564,379,316
	<b>250,772,276</b>	<b>565,128,720</b>

#### 14. Kapitali i nënshkruar

Më 31 dhjetor 2018 kapitali i autorizuar, emetuar dhe i paguar i Shoqërisë është 12,300,000 Lek. Një përmbledhje e kapitalit më 31 dhjetor 2018 dhe 2017 jepet më poshtë:

2018	Ortakët	Lek
Teleperformance SE	100%	12,300,000

Ne 2018 mema e Shoqërisë ndryshoi nga transferimi i aksioneve nga Albania Invest Holding Mauritius tek Teleperformance SE

2017	Ortakët	Lek
Albania Investment Holdings Mauritius	100%	12,300,000

Shoqëria nuk ka të drejta, preferenca apo kufizime të lidhura me kapitalin më 31 dhjetor 2018 dhe 2017.

Gjate vitit 2018, u shpernda dividend nga fitimi i mbartur ne shumen 1,247,000 mije leke (2017: 0)

#### 15. Rezervat

Sipas ligjit të mëparshëm të shoqërive tregtare në Shqipëri, shoqëritë tregtare ishin të detyruara të transferonin një minimum prej pese perqind të ardhurave neto siç paraqitet në librat kontabël në rezerva ligjore deri sa kjo rezervë bëhej e barabartë me një të dhjetën e kapitalit të paguar dhe kjo shumë nuk mund të shpërndahet. Më 14 prill 2008, një ligj i ri për shoqëritë hyri në fuqi në Shqipëri, i cili nuk kërkon që një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar të krijojë rezerva ligjore.

Përdorimi i rezervës ligjore mbetet në vullnetin e aksionereve të Shoqërisë.

#### 16. Llogari të pagueshme

	31 dhjetor 2018	31 dhjetor 2017
Llogari të pagueshme ndaj furnitorëve	84,073,069	139,854,399
	<b>84,073,069</b>	<b>139,854,399</b>

#### 17. Detyrime të tjera

	31 dhjetor 2018	31 dhjetor 2017
Shpenzime të përlllogaritura	16,948,800	8,523,339
Detyrime ndaj personelit	281,381,096	245,505,841
Detyrime të tjera	27,227,248	30,266,822
Tatimi mbi të ardhurat personale dhe sigurimet shoqërore	78,825,485	65,731,242
Tatimi i mbajtur në burim	16,849,311	28,521,289
	<b>421,231,940</b>	<b>378,548,533</b>

# Albania Marketing Service Shpk

## Shënime shpjeguese për pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018

(Vlerat në Lek, përveçse kur thuhet ndryshe)

### 18. Detyrime ndaj palëve të lidhura

	31 dhjetor 2018	31 dhjetor 2017
IN & OUT S.p.a	5,633	722,916
Albania Investments Hlg Mauritius	79,416	218,688,394
Teleperformance SE	13,434,664	269,993
Teleperformance Deutschland	4,094,107	-
TP Emea	55,093,413	71,793,087
GN Research S.p.a	-	8,107,450
	<b>72,707,233</b>	<b>299,581,840</b>

### 19. Të ardhura nga shërbimet

	31 dhjetor 2018	31 dhjetor 2017
Palë të lidhura (shiko shënimin 25)	2,086,854,448	2,112,254,432
Palë të tjera të treta	1,718,828,769	1,477,770,604
	<b>3,805,683,217</b>	<b>3,590,025,036</b>

### 20. Të ardhura të tjera

	31 dhjetor 2018	31 dhjetor 2017
Të ardhura nga qiraja	4,417,419	12,253,536
Të ardhura nga shërbime të tjera	21,233,740	10,095,892
	<b>25,651,159</b>	<b>22,349,428</b>

### 21. Shpenzimet e personelit

	31 dhjetor 2018	31 dhjetor 2017
Paga - supervizorë	258,981,537	241,030,410
Paga - agjentë	1,726,326,161	1,512,701,143
Përfitime të tjera	5,955,280	14,757,016
<b>Shpenzimet e personelit të shërbimit</b>	<b>1,991,262,978</b>	<b>1,768,488,569</b>
Personeli administrativ	301,682,873	280,493,386
<b>Shpenzime të personelit administrativ</b>	<b>301,682,873</b>	<b>280,493,386</b>
<b>Totali</b>	<b>2,292,945,851</b>	<b>2,048,981,955</b>

Shpenzimet e personelit të shërbimit përfaqësojnë koston e agjentëve dhe mbikëqyrësve të përfshirë në fushata. Shpenzimet për personelin janë të detajuara si më poshtë:

	2018	2017
Paga dhe bonuse	1,989,873,921	1,779,750,618
Sigurimet shoqërore dhe shëndetsore	303,071,930	269,231,337
<b>Totali</b>	<b>2,292,945,851</b>	<b>2,048,981,955</b>

### 22. Shpenzime të tjera operative

	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2018	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2017
Shpenzime qiraje	276,096,716	299,085,991
Shërbime mirëmbajtje dhe teknologjie	83,741,998	151,280,129
Tarifa për të drejta shfrytëzimi	101,951,504	95,799,516
Shpenzime utilitare dhe të konsumueshme të tjera	79,815,292	68,253,436
Udhëtime dhe aktivitete	31,800,027	38,284,467
Komunikim, siguri dhe teknologji informacioni	39,867,802	42,397,845
Taksa të tjera	20,907,197	17,594,259
Tarifa çertifikimi dhe anëtarësimi	8,024,738	7,825,542
Shpenzime konsulence dhe ligjore	15,765,013	7,350,411
Mirëmbajtje dhe riparime	8,315,791	7,194,132
Shpenzime marketingu	2,964,702	3,863,338
Shpenzime të tjera operative	20,090,547	8,840,614
	<b>689,341,327</b>	<b>747,769,680</b>

### 23. Shpenzime financiare neto



## Albania Marketing Service Shpk

### Shënime shpjeguese për pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018

(Vlerat në Lek, përveçse kur thuhet ndryshe)

	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2018	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2017
<b>Të ardhura financiare</b>		
Të ardhura nga interesat	23,175,949	18,036,884
	<b>23,175,949</b>	<b>18,036,884</b>
<b>Shpenzime financiare</b>		
Humbje neto nga këmbimi	(133,059,597)	(31,071,111)
	<b>(133,059,597)</b>	<b>(31,071,111)</b>
<b>Shpenzime financiare neto</b>	<b>(109,883,648)</b>	<b>(13,034,227)</b>

#### 24. Tatimi mbi fitimin

Tatimi mbi fitimin përbëhet si më poshtë:

	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2018	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2017
Shpenzimi aktual i tatimit mbi fitimin	108,883,653	122,907,949
	<b>108,883,653</b>	<b>122,907,949</b>

Tatimi mbi fitimin në Shqipëri vlerësohet në normën 15% (2017: 15%) të fitimit të tatueshëm. Në vijim paraqitet një rakordim midis tatimit mbi fitimin të llogaritur me normën e aplikueshme të tatimit dhe shpenzimit të tatimit mbi fitimin:

	2018 %	2018 Në Lek	2017 %	2017 Në Lek
Fitimi para tatimit		595,661,837		665,405,330
Tatimi mbi fitimin me normë standarde	15%	89,349,276	15%	99,810,800
Shpenzime të panjohura	3%	19,534,377	3%	23,097,149
<b>Shpenzimi i tatimit mbi fitimin</b>	<b>18%</b>	<b>108,883,653</b>	<b>18%</b>	<b>122,907,949</b>

Më 31 dhjetor 2018 dhe 2017 nuk ka patur diferenca të përkohshme ndërmjet vlerës kontabël të aktiveve dhe detyrimeve për qëllime të raportimit financiar dhe vlerave të raportuara për qëllime tatimore. Rrjedhimisht, nuk është njohur aktiv ose detyrim tatimor i shtyrë në pasqyrat financiare të Shoqërisë.

Lëvizjet në tatimin mbi fitimin paraqiten si më poshtë:

	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2018	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2017
Tatim fitim i pagueshëm më 1 janar	3,968,714	34,739,957
Shpenzimi aktual i tatimit mbi fitimin	108,883,653	122,907,949
Parapagime gjatë vitit	(129,192,140)	(153,679,192)
Tatim fitimi i pagueshëm më 31 dhjetor	<b>(16,339,773)</b>	<b>3,968,714</b>

#### 25. Palët e lidhura

Shoqëria ka palë të lidhura aksionarët e saj Albania Investment Holdings Mauritius, shoqërinë mëmë përfundimtare Teleperformance France SA, dhe shoqëritë që janë nën kontrollin e shoqërisë mëmë përfundimtare të grupit të paraqitura në tabelën më poshtë.

Shoqëria ka palë të lidhura gjithashtu edhe drejtuesit dhe drejtorët ekzekutivë.

Gjatë vitit Shoqëria ka pasur transaksionet e mëposhtme me palët e lidhura:

## Albania Marketing Service Shpk

### Shënime shpjeguese për pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018

(Vlerat në Lek, përveçse kur thuhet ndryshe)

#### 25. Palët e lidhura (vazhdim)

	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2018	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2017
<b>Pagesa për:</b>		
<i>Tarifa për të drejta shfrytëzimi:</i>		
Albania Investments Holdings Mauritius	15,306,090	95,799,516
Teleperformance SE	86,645,413	
<i>Kosto e blerje të tjera:</i>		
In & OUT S.p.a, Itali	501,367	729,441
Teleperformance SE	2,152,227	1,415,937
Teleperformance Deutschland - Service GmbH	20,104,525	15,770,970
TP EMEA	94,895,386	140,563,867
Teleperformance USA	1,101,137	1,311,356
Teleperformance Group Inc	11,925,233	13,002,765
<b>Totali</b>	<b>232,631,378</b>	<b>268,593,852</b>
<b>Të ardhura nga:</b>		
<i>Të ardhura (shënimi 16)</i>		
In & OUT S.p.a, Itali	1,518,023,633	1,456,628,499
Gn Research S.p.a, Itali	-	7,387,875
TP Emea	568,830,815	648,238,058
<b>Totali</b>	<b>2,086,854,448</b>	<b>2,112,254,432</b>
<i>Të ardhura të tjera</i>		
Interesi nga huaja për Teleperformance SE	23,175,949	18,036,884
Të ardhura të tjera nga Teleperformance SE	17,565,362	4,239,678
Service 800 Albania Sh.p.k	3,730,668	3,960,873
<b>Totali</b>	<b>44,471,979</b>	<b>26,237,435</b>

Për gjendjet në fund të vitit 2018 dhe 2017 referojuni shënimeve 10, 11 dhe 18.

Kompensimi i drejtuesve kryesorë të Shoqërisë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018 është 101,573,097 Lek (2017: 103,688,422 Lek).

#### 26. Angazhime dhe detyrime të mundshme

##### Çështjet ligjore

Shoqëria nuk është subjekt i çështjeve ligjore, pretendimeve dhe mosmarrëveshjeve të lindura në kushte të zakonshme biznesi. Drejtuesit e Shoqërisë mendojnë që pretendimet e mundshme të ardhshme nuk do të kenë një efekt material të padëshiruar në pozicionin financiar të Shoqërisë, rezultatin e aktiviteteve operative apo flukseve të parasë.

##### Angazhime për qiratë operacionale

Shoqëria ka marrë angazhime për qiranë për ambientet e saj, të cilat janë të anullueshme me njoftim paraprak nga një ne gjashtë muaj. Me 31 dhjetor 2018, maksimumi i angazhimeve të paanullueshme të pagueshme është:

	31 dhjetor 2018	31 dhjetor 2017
Deri në 6 muaj	143,931,251	138,068,913
	<b>143,931,251</b>	<b>138,068,913</b>

#### 27. Ngjarje të mëvonshme

Nuk ka ngjarje të tjera të ndodhura pas dates së raportimit për të cilat do të kërkoheshin rregullime ose shënime shpjeguese shtesë në pasqyrat financiare.